

Projekti: Mbështetja e pjesëmarrjes së romëve dhe grupeve vulnerabël në zgjedhjet e vitit 2025
Organizata: IRCA

Objektivi i përgjithshëm: Të kontribuojë në forcimin e proçeseve demokratike zgjedhore në Shqipëri nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së romëve dhe votuesve të tjerë të cënueshëm.

Objektivi specifik: Të nxisë pjesëmarrjen e romëve dhe grupeve të tjera vulnerabël në proçeset zgjedhore.
Indikatorët

70 % e pjesëmarrësve raportojnë rritje të njohurive dhe aftësive për proçeset zgjedhore.

15 përfaqësues të romëve dhe OSHC-ve lokale marrin pjesë në aktivitetin e ngritjes së kapaciteteve dhe të gatshëm për të bashkëpunuar për përgatitjen e raportit të monitorimit të pjesëmarrjes së romëve dhe grupeve të tjera të cënueshme në zgjedhje dhe parregullsive të supozuara/vëzhguara zgjedhore.

Rezultatet e pritshme	Aktivitetet	Indikatorët
1. Rritja e njohurive dhe ndërgjegjësimi të romëve dhe grupeve të tjera vulnerabël për të drejtën e tyre qytetare për të votuar.	Ndërgjegjësimi dhe të kuptuarit i qytetarëve për proçeset zgjedhore. Edukimi i votuesve dhe ndërtimi i njohurive zgjedhore tek të rinjtë si votues të mundshëm për herë të parë, me fokus të veçantë te gratë. Edukata Qytetare përmes Radios online “Kaxxura”.	Të paktën 400 pjesëmarrës në takimet me komunitetin Së paku 150 votues të parë potencial dhe analfabetë do të marrin pjesë në aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve për proçeset zgjedhore. 5 podkaste të prodhuara dhe të transmetuara.
2. Përmirësimi i kapaciteteve dhe rrjetëzimi i romëve dhe OSHC-ve lokale për të kryer monitorim efektiv të proçeseve zgjedhore/politike.	Përmirësimi i kapaciteteve të romëve dhe OSHC-ve të tjera lokale për të kryer monitorim efektiv dhe efikas të zgjedhjeve. Përgatitja e një raporti monitorues për pjesëmarrjen e romëve dhe grupeve të tjera vulnerabël në zgjedhje dhe parregullsive të supozuara/vëzhguara zgjedhore.	15 përfaqësues të romëve dhe OSHC-ve të tjera lokale do të marrin pjesë në aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve. 1 raport monitorimi për pjesëmarrjen e romëve dhe grupeve të tjera vulnerabël në zgjedhje dhe parregullsive të supozuara/vëzhguara zgjedhore.



Funded by
the European Union



IPLS | institute for policy
& legal studies

